



MANUAL PËR MIGRANTËT

KËRKONI INFORMACION TË SAKTË DHE TË BESUESHËM PËR VENDIN KU VENDOSNI TË MIGRONI
KËRKONI INFORMACION TË SAKTË DHE TË BESUESHËM PËR VENDIN KU VENDOSNI TË MIGRONI
KËRKONI INFORMACION TË SAKTË DHE TË BESUESHËM PËR VENDIN KU VENDOSNI TË MIGRONI

KULTURA E VENDIT DESTINACION KULTURA E VENDIT DESTINACION
KULTURA E VENDIT DESTINACION KULTURA E VENDIT DESTINACION

NJOHURI BAZË PËR GJUHËN E VENDIT DESTINACION
NJOHURI BAZË PËR GJUHËN E VENDIT DESTINACION
NJOHURI BAZË PËR GJUHËN E VENDIT DESTINACION

HARTË SHËRBIMESH TË VENDIT KU JU DO TË JETONI DHE PUNONI
HARTË SHËRBIMESH TË VENDIT KU JU DO TË JETONI DHE PUNONI
HARTË SHËRBIMESH TË VENDIT KU JU DO TË JETONI DHE PUNONI

KUJDESUNI TË GJENI DHE RUANI NUMRAT E EMERGENCËS TË VENDIT KU JU BANONI
KUJDESUNI TË GJENI DHE RUANI NUMRAT E EMERGENCËS TË VENDIT KU JU BANONI
KUJDESUNI TË GJENI DHE RUANI NUMRAT E EMERGENCËS TË VENDIT KU JU BANONI

NJOHURI PËR LIGJET E VENDIT DESTINACION
NJOHURI PËR LIGJET E VENDIT DESTINACION
NJOHURI PËR LIGJET E VENDIT DESTINACION



MANUAL PËR MIGRANTËT

Manuali është botuar në kuadër të projektit “*Faktorët e rrezikut dhe vulnerabiliteti ndaj migracionit. Mbështetja e migracionit të sigurtë dhe gjenerimi i strategjive alternative në Kuçovë*” financuar nga Ministria Norvegjeze e Punëve të Jashtme.

Një falenderim i veçantë shkon për partnerët e projektit të cilët janë Fafo për Studime Ndërkombëtare të Aplikuara, (Norvegji), Instituti NEXUS, (Washington DC), dhe Organizata “Të Ndryshëm & Të Barabartë”, Tiranë.

Manuali është pronësi e Bashkisë së Kuçovës, të cilën e falënderojmë bashkë me qytetarët e saj, për kontributin e tyre në realizimin e tij.

Grupi i Punës

HYRJE

Manuali për migrantët është një dokument shumë praktik që do t'u vijë në ndihmë individëve. Ai përmban informacion shumë të rëndësishëm mbi shërbimet në komunitetin ku ata banojnë, për individët që dëshirojnë të kenë një migrim të suksesshëm, për migrantët në vendin e destinacionit, për migrantët e kthyer, si dhe informacion për trafikimin.

Në këtë manual do të gjeni këshilla shumë praktike për të qenë të sigurtë ndërsa ju jeni jashtë vendit, një hartë shërbimesh të Kuçovës, qytetit tuaj dhe të vendit ku jetoni në Greqi, kontakte dhe shërbime për viktimat e trafikimit, të cilat do t'ju ndihmojnë për të adresuar problemet dhe shqetësimet, si dhe për t'ju lehtësuar procesin në zgjidhjen e problemeve dhe nevojave tuaja.

Kuçova



Greqia



PËRMBAJTJA

I. Shërbime dhe burime të ndryshme informacioni në	
Kuçovë	7
a) Asistenca sociale	7
b) Zyra e ndihmës ekonomike	8
c) Departamenti i arsimit	9
d) Kujdesi shëndetësor parësor	10
e) Strehimi në Kuçovë	11
II. Informacion rreth migracionit të sigurtë dhe trafikimit	12
a) Çfarë është migracioni i sigurtë?	12
b) Agjencitë turistike dhe ato të udhëtimit	13
c) Zyra e migracionit	13
d) Të drejtat e migrantëve në punë:	14
e) Çfarë është shfrytëzimi në punë	14
f) Trafikimi	15
g) Mënyrat më të hasura të rekrutimit të viktimave të trafikimit nga trafikantët	15
h) Format e shfrytëzimit të viktimave të trafikimit	15
i) Dokumente të nevojshme për vizë marrë nga Ambasada Greke, Tiranë	17
III. Shërbimet dhe burime të ndryshme informacioni në	
Greqi	19
a) Kriteret e hyrjes	19
b) Llojet e vizave	19
c) Kushtet e hyrjes dhe qëndrimit të punëtorëve të huaj	20
d) Kushtet e punës	21
e) Kushtet e hyrjes dhe të qëndrimit për studentët	22
f) Proçedurat dhe dokumentet që nevojiten për të marrë leje qëndrimi:	23
g) Viza për bashkim familjar	24
h) Lejet e qëndrimit	24

i) Sistemi i kujdesit shëndetësor	25
j) Sistemi i sigurimeve shoqërore	26
k) Strehimi	26
l) Shërbimet mbështetëse që u ofrohen migrantëve	27
m) Trafikimi	28
IV. Informacion për migrantët e kthyer	29
a) Zyra e gjendjes civile	29
b) Departamenti i arsimit	29
c) Zyra e punës	29
d) Zyra e ndihmës ekonomike	30
e) Shërbimi i shëndetit parësor	30
V. ANNEX I, Harta e shërbimeve, Kuçovë	32
VI. ANNEX II, Shërbime për viktimat e trafikimit në Shqipëri dhe Greqi	36
VII. ANNEX III, Harta e shërbimeve, Greqi	42

I.

SHËRBIME DHE BURIME TË NDRYSHME INFORMACIONI NË KUÇOVË

Në këtë seksion të manualit ju do të gjeni informacione të dobishme mbi mundësitë e ndryshme dhe shërbimet në Kuçovë.

a) Asistenca sociale

Në zyrën e punës në qytetin tuaj mund të përfitoni asistencë sociale nëse keni qenë vitin e fundit në punë dhe keni paguar rregullisht kontributet shoqërore. Kjo asistencë është për një vit dhe duhet të paraqitni këto dokumente:

Dokumente	Ku mund t'i merrni?	Tarifa
Çertifikatë familjare	Në zyrën civile	50 lekë
Çertifikatë nga zyra e taksave që personi nuk është subjekt i regjistruar në këto organizma	Në zyrën e taksave	50 lekë
Çertifikatë që vërteton që personi nuk ka tokë	Në qark	100 lekë
Formularë që duhet të plotësohet nga punëdhënësi dhe zyra e taksave/sigurimeve shoqërore	Në zyrën e taksave dhe sigurimeve shoqërore	Falas

Librezat e energjisë elektrike (numri i kontratës)	—	—
Karta e identitetit dhe një kopje e saj	Në zyrën civile	1200 lekë
Vërtetim të ndjekjes së shkollës për fëmijët nën 18 vjeç	Në shkollë	Falas
Vërtetim të ndjekjes së universitetit për studentët deri në 25 vjeç	Në universitet	Falas
Vërtetim për persona me aftësi të kufizuar që janë nën kujdestarinë e një personi që aplikon për asistencë sociale	Në spital nga një komision i veçantë	Falas
Vërtetim nga zyra e sigurimeve shoqërore që vërteton se njeri nga bashkëshortët nuk përfiton pension të plotë	Në zyrën e shërbimeve shoqërore	Falas
Kërkesë me shkrim për përfitimin e pagesës së papunësisë	Nga vetë personi	—
Vërtetim nga Komuna për persona që janë rezident në fshat dhe marrin apo jo ndihmë ekonomike.	Komunë	Falas

Afati për plotësimin e dokumentacionit është 60 ditë pas lënies së punës.

b) Zyra e ndihmës ekonomike

Në bashkinë e qytetit tuaj ndodhet një zyrë e ndihmës ekonomike ku ju mund të drejtoheni dhe të merrni informacionin e duhur rreth kritereve për të përfituar ndihmë ekonomike.

- Familjet pa të ardhura ose me të ardhura të pamjaftueshme.
- Jetimët e papunë, vetëm me statusin e jetimit.
- Prindërit e fëmijëve të lindur trinjakë e më shumë, që u përkasin familjeve në nevojë.
- Viktimat e trafikimit, pas lënies së institucioneve pritëse, deri në sistemimin e tyre në punë.

Masa e ndihmës ekonomike të plotë, mujore, nga fondet e buxhetit qendror, përcaktohet sipas strukturës së familjes dhe përbëhet nga:

<i>Kush përfiton?</i>	<i>Shuma, lek/në muaj</i>
Për kryefamiljarin	2600 lekë
Për anëtarët e familjes mbi moshë pune	2600 lekë
Për çdo anëtar tjetër të familjes, në moshë pune	600 lekë
Për çdo anëtar tjetër të familjes nën moshë pune (deri 18 vjeç)	700 lekë
Masa e ndihmës ekonomike për çdo jetim	3000 lekë
Masa e ndihmës ekonomike për viktimat e trafikimit	3000 lekë

Kjo ndihmë ekonomike përfitohet deri në mbarimin e arsimit të detyrueshëm, por jo më shumë se 18 vjeç.

c) Departamenti i arsimit

Ju keni mundësi të merrni një profesion të ri dhe të ndiqni kurse profesionale në qytetin tuaj. Ju mund të kontaktoni departamentin e arsimit dhe të diskutoni rreth kësaj mundësie me specialistin e kualifikimeve. Në qytetin tuaj ju mund të ndiqni kurse të ndryshme profesionale si kurse për mekanikë, elektronikë. Këto kurse janë falas, zhvillohen pasdite dhe mund të marrë pjesë çdo njeri.

***Mbaroni të paktën arsimin e detyruar 9-vjeçar
Aftësohuni për jetën nëpërmjet kurseve profesionale***

Ju keni mundësi të ndiqni kurse të gjuhëve të huaja si: anglisht, italisht, greqisht në qytetin tuaj dhe pagesa mujore është rreth 2000 (dy mijë) lekë të reja në muaj.

Njohuri e gjuhës së vendit destinacion është një avantazh i madh.

d) Kujdesi shëndetësor parësor

Në qendrën shëndetësore ju mund të merrni shërbimin shëndetësor në përgjithësi, por nëse ju keni nevojë për asistencën e një specialisti ju duhet të merrni një rekomandim nga doktori i familjes.

Mjeku i familjes ndjek pacientët, si në ambulancë ashtu edhe në kushte shtëpiake, kur janë të pamundur për të vizituar qendrën shëndetësore. Personat e pasiguruar mund të marrin shërbimet shëndetësore në qendrën shëndetësore falas vetëm në raste emergjente, në të kundërt ata duhet të paguajnë tarifa të ndryshme për vizita të ndryshme mjekësore.

Dokumente që nevojiten për pensionistët, fëmijët dhe të papunët:

- Pensionistët duhet të kenë librezën e pensionit, numrin e kartelës të hapur nga doktori i familjes dhe librin e shëndetit;
- Për fëmijët nevojitet një çertifikatë me foto dhe një vërtetim që provon se ai/ajo ndjek shkollën;
- Të papunët duhet të marrin një vërtetim nga zyra e punës si punëkërkues.

Kostot për vizitat mjekësore për persona të pasiguruar:

Nr.	Vizitat	Kostoja
1.	Vizitë te mjeku i familjes	1000 lekë
2.	Vizitë te mjeku specialist në poliklinikë	1500 lekë
3.	Kryerje e injeksioneve	150 lekë

4.	Manipulime kirurgjikale ambulatorë	500 lekë
5.	Glicemia (matja e sheqerit në gjak)	300 lekë
6.	Aerozolo terapi	300 lekë
7.	Lëshimi i raporteve për drejtim automjeti	1000 lekë
8.	Dhënie epikrizë për efekt KML KEMP ose jashtë shtetit	300 lekë
9.	Vizitë te mjeku specialist në spitalet rajonale	2000 lekë
10.	Vizitë te mjeku specialist në spitalet universitare	3000 lekë

e) Strehimi në Kuçovë

Kostoja e jetesës: qiraja, ushqimi, transporti publik.

	Kostoja	Komente
Qiraja: Apartament	Maksimumi 15 000 lekë Minimumi 3 000 lekë	3000 lekë është çmimi për një apartament në periferi të qytetit.
Taksat lokale	Maksimumi 2 800 lekë	Energjia, telefoni, uji, taksë e pastrimit.
Ushqimi	Rreth 18 000-20 000 lekë në muaj.	
Transport publik, Kuçovë-Berat	80 lekë	
Kostoja mesatare në muaj	Rreth 25 000-30 000 lekë	

Kontakttoni dhe merrni informacion rreth shërbimeve që ofrojnë OJF-të dhe Institucionet në Kuçovë. ANNEX I

II.

INFORMACION RRETH MIGRACIONIT TË SIGURTË DHE TRAFIKIMIT

a) Çfarë është migracioni i sigurtë?

Migracioni i sigurtë do të thotë, të marrësh masa të mbrosh veten që në momentin që lini vendin deri sa të ktheheni. Nëse janë marrë masat e duhura dhe janë bërë përgatitjet e duhura migracioni formal dhe informal janë të sigurtë.

Migracioni formal është i regjistruar dhe bëhet përmes agjencive të licencuara të punësimit dhe marrëveshjeve ndërmjet ndërmarrjeve apo qendrave të trajnimeve profesionale apo zyrave lokale të punës. Edhe pse migracioni po bëhet më i zakonshëm shumica e migrantëve lëvizin përmes kanaleve/mënyrave informale që përfshijnë lidhje personale, agjenci të palicencuara, apo migrim spontan. Migrantët akoma gjejnë punë përmes shokëve, kushërinjve dhe të njohurve. Migrantët besojnë te këto rrjete personale, por informacioni që ato japin nuk mund të jetë gjithmonë i besueshëm apo i saktë dhe sigurisht është i kufizuar. Të gjitha përgatitjet për një migracion të sigurtë mund të jenë konsumim kohe, por vonesa mund të rezultojë në kushte pune dhe jetese më të mira dhe të sigurta.

Migrantët shpesh gjenden duke punuar në kushte të këqija dhe me pagesë të ulët. Shumë njerëz nuk kuptojnë që migrimi informal mund të çojë në trafikim apo në kushte të tmerrshme pune.

Nëse jeni nën moshën 16 vjeç mos migroni të pashoqëruar nga familjarët.

Nëse keni nevojë për ndihmë kur ju arrini në një vend të panjohur, aty mund të ketë zyrë shërbimesh për migrantët. Përpquni të mësoni rreth migrimit, përpara se të shkoni atje.

b) Agjencitë turistike dhe ato të udhëtimit

Në qytetin tuaj ndodhen agjenci turistike ku ju mund të merrni informacion rreth vendit ku mund të udhëtoni, dokumente që ju nevojiten, punët sezonale. Qytetet kryesore ku migrantët nga Kuçova shkojnë në Greqi janë: Athina, Volos, Larisa, Trikala, Peleponese, Tripoli dhe Sparta.

Liberalizimi i vizave ka ndihmuar qytetarët e Kuçovës për të lëvizur më lehtë se sa më parë kryesisht në Greqi por edhe në vende të tjera për t'u takuar me familjarët e tyre, dhe si pasojë numri i persona që udhëtojnë jashtë Shqipërisë është më i madh.

Në këto agjenci njerëzit marrin informacion për punët sezonale si punë në bujqësi, mbjellje, korrje, duhan apo ullinj.

Zgjidhni me kujdes vendin në të cilin doni të migroni, merrni njohuri rreth ligjeve dhe kulturës së atij vendit nëpërmjet internetit apo migrantëve të kthyer, para se të migroni.

c) Zyra e migracionit

Në Berat pranë Drejtorisë së Policisë ndodhet zyra e migracionit. Atje mund të merrni këshilla të rëndësishme dhe informacion të vlefshëm rreth të drejtave të migrantëve.

Eksploroni vendin e punës para se të filloni punë, dhe sigurohuni se ndjeheni rehat me kushtet.

d) Të drejtat e migrantëve në punë:

- Pagesa;
- Orët e punës dhe pushimet;
- Siguracionet.

Kontrata e punës e cila duhet të përmbajë:

- Kohëzgjatjen;
- Përshkrimin e punës;
- Kushtet e punës;
- Disiplinën në punë;
- Shpërblimin;
- Mbylljen dhe shkeljen e kontratës së punës.

Firmosni një kontratë me punëdhënësin. Mësoni të drejtat tuaja të punës.

e) Çfarë është shfrytëzimi në punë

Shumë njerëz janë akoma të paqartë rreth të drejtave që migrantët kanë, ju jeni të shfrytëzuar:

- Nëse punoni nën moshën 16 vjeç;
- Nëse abuzoheni fizikisht dhe seksualisht;
- Nëse punoni me orë të zgjatura (40-44 orë punë në javë mesatarisht);
- Nëse merrni një rrogë më të vogël se sa minimumi lokal. Mbajtja e rrogës shpesh është një mënyrë kontrolli për t'u siguruar që punëtori nuk largohet;
- Nëse jeni nën moshën 18 vjeç, dhe puna në ambientin ku punoni rrezikon shëndetin tuaj, sigurinë dhe moralin.

f) Trafikimi

Të gjitha qëniet njerëzore janë të lindur me të drejta të caktuara, të gjitha qëniet njerëzore kanë të drejtë të jenë të lirë, të ushqehen dhe të jenë të lumtur. Në kohëra të ndryshme dhe në vende të ndryshme njerëzit kanë qënë të privuar nga të drejtat e tyre humane. Trafikimi sot po ndodh në shumë vende ku vajzat janë mashtruar dhe detyruar të bëjnë diçka që ato nuk e duan. Trafikimi i qënieve njerëzore ka një efekt shkatërrues në individët viktimë të trafikimit, të cilët shpesh vuajnë nga abuzime fizike dhe emocionale, përdhunim, kërcënim ndaj vetë atyre apo familjarëve.

g) Mënyrat më të hasura të rekrutimit të viktimave të trafikimit nga trafikantët

- Premtimet false për martesë apo marrëdhënie romantike false për t'i tërhequr viktimat jashtë shtetit për shfrytëzim seksual;
- Premtime për punë;
- Mashtrim për studime;
- Rrëmbim;
- Njoftime false në gazeta apo internet;
- Nëpërmjet agjencive turistike, agjencive të punësimit etj.

h) Format e shfrytëzimit të viktimave të trafikimit

- Shfrytëzim për prostitucion apo forma të tjera të shfrytëzimit seksual;
- Shfrytëzim i punës së detyruar;
- Shfrytëzim i fëmijëve për lypje;
- Për shërbim ushtarak;
- Për martesë të detyruar;
- Për punët e shtëpisë;
- Për përfshirje në aktivitete kriminale;
- Për transplant organesh;

- Për qëllime adoptimi ilegal të fëmijëve;
- Përdorim i femrave për qëllime riprodhimi etj.

Rrugët e lëvizjes së viktimave janë një optikë tjetër e përdorur për të vlerësuar dhe luftuar trafikimin e qenieve njerëzore. Është e rëndësishme të përmendet që lëvizja e viktimës për qëllim shfrytëzimi mund të ndodhë si brenda vendit, pa kaluar kufijtë shtetërorë, që i referohen si trafikim i brendshëm, ashtu edhe nga një shtet në tjetrin, kalim të cilin trafikantët e kryejnë qoftë si kalim të ligjshëm, të rregullt, apo si kalim të paligjshëm, të parregullt të kufirit.

Jeni të vetëdijshëm për rreziqet e migracionit kryesisht për trafikimin dhe shfrytëzimin.

Mos u pajto me të huaj gjatë rrugës, ato mund të jenë trafikantë dhe mund t'ju joshin ju për në shfrytëzim.

Mos udhëtoni vetëm. Grupi ju ofron mbështetje sociale dhe siguri.

Udhëtoni me transport publik kur ju shkoni për herë të parë në destinacion dhe asnjëherë me veturë me njerëz të panjohur.

Kontaktoni dhe merrni informacion rreth shërbimeve që ofrojnë OJF-të dhe Institucionet për viktimat e trafikimit në Shqipëri dhe Greqi. ANNEX II

i) Dokumente të nevojshme për vizë marrë nga Ambasada Greke, Tiranë

Dokumentacioni për bashkim familjar	Dokumentacioni për punë sezonale
<ul style="list-style-type: none"> - Aplikim i plotësuar dhe i firmosur. Kjo formë jepet falas nga zyra e Konsullatës; - 2 foto të fundit; - Pasaportë e vlefshme apo çdo dokument tjetër që njihen në Greqi; - Çertifikatë familjare; - Çertifikatë martese; - Dëshmi penaliteti dhënë nga Ministria e Drejtësisë së Shqi-përisë; - Çertifikatë shëndetësore që vërteton që personi nuk vuan nga ndonjë sëmundje infektive; - Një kopje e vendimit të bashkimit familjar lëshuar nga prefektura respektive në Greqi; - Leja e qëndrimit të bashkëshortit ose fotokopje e legalizuar nga autoritet Greke. 	<ul style="list-style-type: none"> - Aplikim i plotësuar dhe i firmosur. Kjo formë jepet falas nga zyra e Konsullatës; - 2 foto të fundit; - Pasaportë e vlefshme apo çdo dokument tjetër që njihen në Greqi; - Çertifikatë lindjeje; - Dëshmi penaliteti dhënë nga Ministria e Drejtësisë së Shqi-përisë; - Çertifikatë shëndetësore që vërteton që personi nuk vuan nga ndonjë sëmundje infektive; - Siguracion i jetës dhe shëndetit në udhëtim.
Dokumentacioni për vizë studimi	Dokumentacioni për lëshimin e vizave speciale për homogjenët

<ul style="list-style-type: none"> - Aplikim i plotësuar dhe i firmosur. Kjo formë jepet falas nga zyra e Konsullatës; - 2 foto të fundit; - Pasaportë e vlefshme apo çdo dokument tjetër që njihen në Greqi; - Vërtetim nga institucioni arsimor që pranon regjistrimin e personit. Nëse institucioni është privat vërtetimi duhet legalizuar nga autoritetet respektive në Prefekturë; - Vërtetim për mjetet e disponueshme për përballimin e shpenzimeve të studimeve dhe jetesës në Greqi; - Çertifikatë lindjeje; - Dëshmi penaliteti dhënë nga Ministria e Drejtësisë së Shqipërisë; - Çertifikatë shëndetësore që vërteton që personi nuk vuan nga ndonjë sëmundje infektive; - Siguracion i jetës dhe shëndetit në udhëtim. 	<ul style="list-style-type: none"> - Aplikim i plotësuar dhe i firmosur. Kjo formë jepet falas nga zyra e Konsullatës; - Vërtetim nga Alpha Bank; - 2 foto të fundit; - Pasaportë e vlefshme apo çdo dokument tjetër që njihen në Greqi; - Çertifikatë lindjeje; - Çertifikatë familjare; - Fotokopje e një dokumenti te vëcantë të legalizuar të Homogjenit (karte), ose origjinali i anëtarëve të familjes dhe fotokopje e vizave; - Një çertifikatë e trungut fami-ljar që vërteton marrëdhëniet tuaja me anëtarët e familjes që janë të përshtirë në çertifikatë, si dhe origjina e tyre; - Çdo dokument tjetër me të cilin provoni origjinën tuaj helene.
--	---

Të gjitha dokumentet e lartpërmendura duhet të jenë edhe fotokopje.

Të gjitha dokumentet lëshuar nga Autoritet Shqiptare duhet të legalizohen nga Ministria e Punëve të Jashtme të Republikës së Shqipërisë.

Të gjitha dokumentet e kërkuara duhet të dorëzohen nga personi vetë në ditën e intervistës.

III.

SHËRBIMET DHE BURIME TË NDRYSHME INFORMACIONI NË GREQI

Ky seksion ju jep informacionin specifik për të cilin mund të keni nevojë gjatë vizitës në një vend të caktuar. Nëse planifikoni të shkoni në një vend ju mund të kontaktoni Ambasadën apo Konsullatën e atij vendi në Shqipëri, ose gjeni informacion në internet për viza dhe dokumente që ju kërkohen.

a) Kriteret e hyrjes

Nëse ju doni të udhëtoni për në Greqi duhet të paraqitni një pasaportë të vlefshme ose ndonjë dokument tjetër udhëtimi të njohur nga Konventa Ndërkombëtare dhe vizën e lëshuar nga Konsullata Greke, nëse planifikoni të qëndroni më tepër se tre muaj. Vizat ndahen në dy kategori: viza për qëndrim të shkurtër (të ashtuquajturat vizat Shengen të vlefshme deri në tre muaj) dhe vizat për qëndrim të gjatë (të ashtuquajturat vizat e shtetësisë së vlefshme për më shumë se tre muaj).

b) Llojet e vizave

- Viza Schengen;
- Viza studimi;
- Viza pune si i punësuar;
- Viza pune në aktivitet të pavarur ekonomik;

- Viza për bashkimi familjar;
- Viza për arsye të tjera – sporte, drejtues dhe punonjës shoqërisht, artistë.

c) Kushtet e hyrjes dhe qëndrimit të punëtorëve të huaj

Për të lëshuar vizën e punës, Konsullata zakonisht kërkon:

- një pasaportë të vlefshme;
- një vërtetim shëndetësor nga një spital shtetëror;
- një dëshmi penaliteti;
- sigurimin shëndetësor.

Dokumentet mund të ndryshojnë rast pas rasti. Viza lëshohet brenda disa ditësh, në varësi të ngarkesës së punës që ka Konsullata.

Pasi është lëshuar viza për punë, ju duhet të aplikoni për leje qëndrimi me qëllim punësimi pranë Bashkisë së vendit ku qëndroni, para se të filloni punë në Greqi. Dokumentet bazë që duhet të dorëzoni janë:

- Viza e punës;
- Kontrata ndërmjet punëdhënësit dhe punëmarrësit;
- Pasaporta;
- Tarifa – 150 Euro (në vit);
- Formulari i aplikimit për lëshimin e lejes së qëndrimit në Bashki.

Lista nuk është e plotë. Meqenëse kjo listë mund të ndryshojë, ju duhet të kërkontë në Bashki listën e të gjitha dokumenteve që duhet të paraqisni. Në varësi të bashkisë dhe ngarkesës së tyre të punës, duhet një kohë nga 2 javë deri në 3 muaj për të lëshuar leje qëndrimi me qëllim punësimi. Pasi keni dorëzuar aplikimin për lejen e qëndrimit, ju merrni një vërtetim për dorëzimin e aplikimit dhe ndërkohë, mund të filloni të punoni menjëherë.

Për shkak se rregullat për viza janë objekt i ndryshimeve të vazhdueshme, është e nevojshme që të kërkonit rregullat më të fundit në faqen elektronike të ambasadës greke ose të vendit tuaj të qëndrimit.

Ndërsa ju banoni në Greqi fëmijët tuaj kanë nevojë të vazhdojnë shkollën. Për regjistrimin e fëmijëve në shkollë ju duhet të keni një çertifikatë të fëmijës nga shkolla e vendit të origjinës, e firmosur nga departamenti i arsimit, nga Ministria e Arsimit dhe nga Ambasada greke në vendin tuaj.

d) Kushtet e punës

Kontrata e punës ndërmjet punëdhënësit dhe punëmarrësit duhet të përfshijë kushtet e punësimit si p.sh. pagën, orët e punës, pushimet, kompensimin dhe njoftimin në rast ndërpreje të kontratës për kontratat me periudhë të pacaktuar etj. Kontratat për periudha të caktuara duhet të theksojnë kohëzgjatjen e kontratës, te data e përfundimit të kontratës.

Forma më e zakonshme e kontratës së punësimit është kontrata e punësimit me kohë të plotë, për një kohë të papërcaktuar. Punësimi me kohë të pjesshme është shumë i kufizuar në krahasim me vendet e tjera të BE-së.

Punësimi sezonal është i zakonshëm në fushën e turizmit, si dhe në profesione që lidhen drejtpërdrejt me turizmin. Punëtorët dhe teknikët, kryesisht në ndërtim dhe sektorët e bujqësisë, zakonisht paguhen një herë në javë mbi bazën e pagesës ditore.

Shkalla e pagesës minimale në Greqi varet nga eksperiencia e viteve të punës që ju keni. Me të përfunduar çdo tre vjet punë, pagesa minimale rritet. Më datë 1 maj 2007, pagesa minimale ditore për një punëtor të pakualifikuar u caktua në shumën 29.39 Euro dhe pagesa minimale mujore për një punëtor të

pamartuar u caktua në shumën 657.89 Euro. Nëse ju jeni paguar më pak se kaq ju mund të jeni shfrytëzuar.

Punonjësit mund të paguhen mbi bazë ditore, javore ose mujore. Punëdhënësi mban pagesat e detyrueshme të punonjësit (kontributin e sigurimit shoqëror dhe taksën e të ardhurave) përpara se të kryejë pagesën. Punëdhënësi i paguan kontributet e sigurimit shoqëror të punonjësit pranë organeve të sigurimit shoqëror, bashkë me kontributin e punonjësit. Ai paguan gjithashtu edhe ndonjë taksë të zbritur për fitimet pranë zyrës së taksave. Punëdhënësi mban një regjistër të detajuar të listës së pagave. Punonjësi mund të marrë një analizë mujore me shkrim të fitimeve të tij, për të ditur pagesën, rrogën dhe shumën e shtesave dhe zbritjeve.

e) Kushtet e hyrjes dhe të qëndrimit për studentët

Nëse ju dëshironi të studioni në Greqi, ju duhet të keni një vizë studenti të vlefshme, lloji D. Viza e studentit është një vizë tre-mujore, me një hyrje, me të cilën ju keni të drejtë për të aplikuar për leje qëndrimi kur mbërrini në Greqi. Leja e qëndrimit është e vlefshme për një vit dhe mund të zgjatet deri në përfundimin e studimeve. Kësaj periudhe kohe i shtohet edhe një vit tjetër për t'u krijuar mundësinë për të mësuar gjuhën greke, nëse kjo e fundit kërkohet nga institucioni përkatës arsimor. Qeveria greke lëshon viza studenti për studime me kohë të plotë me marrëveshjen që ju do të qëndroni aty ku zhvillohen studimet (dhe jo të zhvillonin mësimin në distancë, për shembull) dhe që ju keni fonde të mjaftueshme për të përballuar tarifat e shkollimit dhe shpenzimet e jetesës në Greqi.

Në mënyrë që të lëshohet vizë studimi, shtetasi i një vendi të tretë duhet të plotësojë këto kushte:

- Të ketë një dokument pranimi nga një institucion arsimor grek;

- Të ketë burime të mjaftueshme financiare për të përballuar shpenzimet e studimeve dhe qëndrimit në Greqi;
- Të ketë një pasaportë dhe/ose dokumente të tjera udhëtimi;
- Të ketë çertifikatë regjistrimi nga institucioni përkatës grek;
- Të ketë një dëshmi penaliteti të pastër lëshuar nga autoritetet e vendit të origjinës.

Të njëjtat kushte zbatohen për programe trajnimi dhe kurse profesionale. Personi që ka leje studimi lejohet të punojë vetëm me kohë të pjesshme, me kusht që ai/ajo të sigurojë lejen për punë me kohë të pjesshme.

f) Proçedurat dhe dokumentet që nevojiten për të marrë leje qëndrimi:

- Aplikimi pranë autoriteteve të bashkisë apo komunës së vendit të qëndrimit të aplikantit, të paktën dy muaj përpara se të përfundojë afati i vizës, duke dhënë arsyet e aplikimit për leje qëndrimi;
- Një vizë e vlefshme;
- Një kopje e pasaportës;
- Çdo dokument tjetër mbështetës në lidhje me llojin e lejes së qëndrimit (prova të banesës së siguruar, sigurimeve, çertifikatës shëndetësore, prova të mjeteve financiare, dëshminë e penalitetit, si dhe ndonjë dokument tjetër shoqërues).

Bashkitë ia dërgojnë dosjen përkatëse Shërbimit për të Huajt dhe Imigracionin të rajonit brenda 15 ditëve pasi është dorëzuar. Shërbimi është përgjegjës për shqyrtimin e aplikimit brenda një muaji. Leja e qëndrimit jepet me vendim të Sekretarit të Përgjithshëm të Rajonit pasi është marrë mendimi i Komitetit të Imigracionit. Për sa i takon lejeve të qëndrimit të lëshuara nga Ministria e Brendshme, aplikimi

përkatës dorëzohet pranë Drejtorisë përkatëse në Ministri.

Leja e parë e qëndrimit është e vlefshme për një vit. Afati i saj mund të zgjatet çdo dy vjet. Aplikimet për zgjatjen e lejeve të punës duhet të dorëzohen jo më vonë se dy muaj para përfundimit të afatit të lejes ekzistuese. Dokumentet që kërkohen mund të jenë të njëjta si për aplikimin fillestar.

g) Viza për bashkim familjar

Nëse ju qëndroni në mënyrë të ligjshme në Greqi dhe dëshironi të aplikoni për bashkim familjar duhet të paraqitni një kërkesë për vizë në vendin e qëndrimit në Greqi duke dorëzuar dokumentet e mëposhtme në komunën ku ju banoni:

- kopje të noterizuar të lejes së qëndrimit;
- deklaratën e të ardhurave (ekatharistiko) nga zyra e taksave për vitin e fundit financiar;
- çertifikatë familjare të kohëve të fundit;
- deklaratë të thjeshtë që pjesëtarët e familjes do të jetojnë me të;
- deklaratë të thjeshtë në të cilën jepet adresa e tij/saj;

Sekretari i Përgjithshëm i vendit ku qëndron shtetasi i huaj me qëndrim të ligjshëm në Greqi, pasi merr vendimin, informon zyrën konsullore greke në shtetin ku qëndron familja e shtetasit të huaj, e cila më pas lëshon vizën për pjesëtarët e familjes.

h) Lejet e qëndrimit

Pjesëtarët e familjes që kanë mbërritur në Greqi me vizë duhet të paraqesin një aplikim për leje qëndrimi në vendin e qëndrimit të tyre.

- Për fëmijë mbi 14 vjeç, duhet të lëshohet leje personale qëndrimi, ndërsa kërkesa bëhet nga kujdestari ligjor i fëmijës.

- Për fëmijë nën 14 vjeç dhe për fëmijë që kanë lindur në Greqi, qëndrimi i tyre mbulohet nga leja e qëndrimit të kujdestarit ligjor të fëmijës.

Mbani kontakte me persona të rëndësishëm në komunitetin ku ju banoni si me kryeplakun e fshatit, policinë, avokatin etj.

Mbani kontakte të rregullta me familjen tuaj dhe shokët e ngushtë. Tregojuni atyre rreth ndonjë ndryshimi në kontakte apo ndonjë problemi që mund të keni.

Eksploroni vendin ku ju banoni dhe identifikoni qendrën më të afërt komunitare, stacionin e policisë dhe spitalin.

Mbani gjithmonë me vete numrat e emergjencës si: numrin e policisë, të spitalit dhe të zjarrfikësit etj.

i) Sistemi i kujdesit shëndetësor

Për të përfituar nga sistemi shëndetësor grek, ju duhet të jeni i siguruar në një fond sigurimi shtetëror. Fondi kryesor i sigurimeve, që mbulon punësimin e varur është Instituti i Sigurimeve Shoqërore (I.K.A). Sigurimi është i detyrueshëm dhe fillon që ditën e parë të punësimit. Si punëdhënësit ashtu edhe punëmarrësit marrin pjesë në kontributet e sigurimeve në fondin e sigurimit: punëdhënësit duhet të paguajnë kontributet e tyre (kontributin e punëdhënësit), si dhe shumën që ata zbresin nga pagesat ditore ose mujore të punonjësve të tyre (kontributi i punonjësit) te zyrat lokale të fondit të sigurimeve. Pasi ju jeni i siguruar pranë një fondi shtetëror, ju mund të përfitoni Shërbimin Shtetëror Shëndetësor dhe ndihmën sociale, sipas rregullave në fuqi.

Ju duhet të merrni një librezë shëndetësore nga zyra vendore e sigurimeve sapo filloni punën. Libreza duhet të paraqitet në çdo rast të vizitave te mjeku ose në spital. Nëse ju jeni migrant i ligjshëm, ju dhe fëmijët tuaj mund të përfitonit të gjitha shërbimet mjekësore ashtu si qytetarët grekë por nëse jeni i paligjshëm ju mund të përdorni librin e shëndetit të një anëtarit të familjes/shoku ose ju duhet të paguani një shumë të konsiderueshme për të marrë shërbimin.

j) Sistemi i sigurimeve shoqërore

Sigurimi shoqëror është i detyrueshëm në Greqi. Organi i përgjithshëm për sigurimin shoqëror të personave të punësuar është Instituti i Sigurimit Shoqëror (IKA). Ka edhe fonde të tjera sigurimesh si p.sh.: OGA (Organizata për Sigurimet Bujqësore) e cila mbulon personat e punësuar në sektorin bujqësor. Ligji i ri për Sigurimet/Pensionet, i miratuar së fundi nga Parlamenti, parashikon unifikimin e një sërë fondëve të sigurimeve në gjashtë fonde kryesore sigurimesh – IKA (për punësimin e varur), OAEE (për profesionistët në profesion të lirë), OGA (për të punësuarit në bujqësi), Shkencëtarët (për mjekët, inxhinierët dhe juristët), punonjësit e administratës publike dhe ata të punësuar në shtyp.

k) Strehimi

Kostoja e jetesës: Qiraja, ushqimi, transporti publik

	Shpenzimet	Komente
Qiraja: Apartament me dy dhoma Një dhomë në një apartament të përbashkët	Minimumi 450 Euro Minimumi 300 Euro	Çmimi në kryeqytet mund të jetë më pak i shtrenjtë, në varësi të madhësisë dhe vendndodhjes së apartamentit.
Shërbimet komunale	52 Euro	Gazi, energjia elektrike, telefoni.

Ushqimi	120 Euro	Duke përjashtuar pijet alkoolike.
Transport publik (autobus deri në 3 km)	25 Euro	Në muaj
Shpenzimet mesatare në muaj	Afërsisht, 497-647 Euro	Duke përjashtuar sigurimet

I) Shërbimet mbështetëse që u ofrohen migrantëve

Sindikatat dhe OJF-të mund t'i informojnë punonjësit migrantë për të drejtat e tyre dhe për shërbimet ligjore për të ngritur padi për kompensim ndaj shfrytëzimit nga punëdhënësit apo agjencitë e rekrutimit.

Paditë për kompensim mund të bëhen p.sh. mbi bazën e arsyeve të mëposhtme:

- Nëse punëdhënësi nuk ka zbatuar kushtet e kontratës si p.sh. pagesë poshtë asaj të përcaktuar ose mospagesë;
- Nëse punonjësi është pushuar pa arsye dhe pa proces të drejtë;
- Nëse punonjësi është detyruar të ndërpresë kontratën për shkak të praktikave të padrejta të punës ose trajtimit çnjerëzor;
- Nëse punonjësi ka qenë objekt i ndonjë forme abuzimi, ngacmimi ose kërcënimi;
- Nëse punonjësi ka përjetuar lëndime dhe dëmtim fizik.

Gjykatat e punës

Migrantët ligjorë kanë të drejtën të kërkojnë pagesat e tyre në gjykatë. Ata kanë saktësisht të njëjtat të drejta si shtetasit grekë në lidhje me gjykatat e punës, në lidhje me punësimin dhe gjithashtu në fusha të tjera të ligjit. Kur migrantët përballesh me ndonjë problem ato ndihmohen nga avokatët. Megjithatë, migrantët e parregullt nuk i kanë këto të drejta, pasi kriteri bazë është të kesh lejet e nevojshme.

m) Trafikimi

Viktimave të trafikimit të qenieve njerëzore, të cilat kanë vuajtur nga shfrytëzimi i rëndë dhe që konsiderohen në rrezik si rezultat i largimit nga kjo situatë, u jepet një periudhë reflektimi 30-ditore në mënyrë që të marrin mbështetjen psiko-sociale të nevojshme për t'u ndierë më të fortë dhe për të shpëtuar nga ndikimi i kriminelëve. Për rrjedhojë, viktima mund të vendosë nëse do të bashkëpunojë me policinë dhe autoritetet gjyqësore dhe më pas mund t'i jepet edhe leja e qëndrimit. Leja e qëndrimit lëshohet nga Ministria e Brendshme, nuk kërkon pagesën e ndonjë tarife dhe afati i saj mund të zgjatet. Personat që kanë këtë leje qëndrimi mund të futen në tregun e punës dhe të sigurojnë trajnime profesionale, arsim, kujdes shëndetësor etj. Pas një muaji nga përfundimi i procedurave të gjykatës, personi që ka lejen e qëndrimit me statusin e viktimës së trafikimit të qenieve njerëzore, mund të marrë një leje qëndrimi për arsye të tjera.

Kontakttoni me Ambasadën/Konsullatën tonë në Greqi për çdo shqetësim apo problem gjatë kohës të qëndrimit tuaj në Greqi.

Kontakttoni dhe merrni informacion rreth shërbimeve që ofrojnë OJF-të dhe Institucionet në Greqi. ANNEX III

IV.

INFORMACION PËR MIGRANTËT E KTHYER

a) Zyra e gjendjes civile

Regjistroni fëmijët tuaj në gjendjen civile të qytetit\komunës nëse nuk janë të regjistruar.

Në gjendjen civile të qytetit tuaj do të gjeni staf të cilët do t'ju ndihmojnë për zgjidhjen e problemeve që ju mund të kenë si: regjistrimin e fëmijëve në gjendjen civile, divorce apo probleme të tjera.

b) Departamenti i arsimit

Stafi i drejtorisë arsimore të qytetit tuaj do t'ju orientojë dhe sqarojë rreth udhëzimeve të Ministrisë së Arsimit për të ndihmuar fëmijët e migrantëve të kthyer, puna me fëmijët e klasës së parë, botimi i abetares për këto fëmijë, si dhe puna e diferencuar me fëmijët e moshave më të rritura. Në qytetin tuaj ju mund të ndiqni kurse të ndryshme profesionale si kurse për mekanikë, elektronikë. Këto kurse janë falas, do të zhvillohen pasdite dhe mund të marrë pjesë çdo njeri.

c) Zyra e punës

Në zyrën e punës ndodhet “Sporteli i migracionit” ku të gjithë migrantët mund të marrin informacion mbi:

- Vizat;

- Shërbimet dhe këshillimet;
- Kushtet e punësimit dhe të jetesës;
- Studimin jashtë vendit;
- Programet e migrimit;
- Të drejtat dhe mbështetjen për migrantët;
- Bashkimin familjar;
- Programet e riintegritimit në Shqipëri për migrantët e kthyer;
- Sportelin e Migracionit mund të ndihmojë migrantët me kërkime në internet, aftësim për hartim CV, përgatitje për intervistë (falas).

d) Zyra e ndihmës ekonomike

Në zyrën e ndihmës ekonomike migrantët e kthyer mund të mësojnë nëse përfitojnë nga kjo zyrë dhe cilat janë kriteret për të përfituar këtë ndihmë. Për këtë qëllim ju duhet të përmbushni ca kushte dhe të plotësoni ca dokumente në këtë zyrë. Nëse ju plotësoni të gjitha kushtet e nevojshme ju mund të regjistroheshi në skemën ekonomike që në muajin pasardhës.

e) Shërbimi i shëndetit parësor

Paraqituni te doktori i familjes për vaksinimin e fëmijëve dhe marrjen e shërbimeve mjekësore, pajisjen me librin e shëndetit. Si të gjithë qytetarët e tjerë edhe migrantët përfitojnë shërbime mjekësore të nevojshme. Ato duhet të dorëzojnë disa dokumente si: librezën e pensionit, numrin e kartelës së hapur te doktori i familjes, librezën shëndetësore etj.

Për fëmijët nevojiten një çertifikatë me fotografi dhe një vërtetim nga shkolla.

Të papunët duhet të paraqesin një vërtetim nga zyra e punës si punëkërkuës. Pasi marrin këtë vërtetim paraqiten në zyrat e shërbimit parësor ku marrin shërbimin e duhur.

Biznesi privat

Vizitoni zyrën e duhur në Bashkinë e qytetit për të marre informacion nëse ju dëshironi të hapni një biznes.

Nëse keni vendosur të hapni një biznes privat paraqituni në zyrat e Bashkisë së qytetit tuaj, aty mund të merrni udhëzimet e duhura për këtë qëllim. Ato mund t'ju lehtësojnë procesin dhe t'ju pajisin me informacionin e duhur për hapjen e biznesit tuaj familjar.

ANNEX I

Harta e shërbimeve në Kuçovë

Emri i organizatës/ institucionit	Shërbime psiko-sociale	Asistencë ligjore/ siguria	Trajnime profesionale	Shërbime mjekësore	Aktivitete edukative dhe rikrijuese.	Shelter	Asistencë për fëmijë	Kontakte
Drejtoria e policisë		- Hetime; - Ankesa; - Mbrojtje.	--	--		--	Identifikimi dhe mbrojtja e fëmijëve në rrezik.	129
Shoqata Amaro Drom	--	--	Trajnime profesionale dhe mundësi punësimit.	--	Aktivitete për komunitetin rom.	--	Kopsht për fëmijët rom.	Ahmet Sinani 0682654254 0695877743
Qendra Rinore	--	--	--	--	- Trajnime;- Aktivitete rikrijuese; - Internet;- Bibliotekë.	--		03 11 231 53 KucovëQendra Rinore@gmail.com

Drejtoria Arsimore	-	-	-	-	-	-	-	-	Regjistrimi i fëmijëve në sistemin shkollor.	0311 227 42 0311 227 45 0311 224 69
Qendra e shëndetit parësor	-	-	-	-	-	-	-	-	- Konsultori i fëmijëve.	
	-	-	-	-	-	-	-	-	-	
Shoqata e jetimeve	-	-	-	-	-	-	-	-	Asistencë për jetimët.	0311 226 52
Qendra Kulturore e fëmijëve	-	-	-	-	-	-	-	-	Kurse të ndryshme artistike dhe sportive për fëmijët e sistemit parashkollor dhe 9-vjeçar.	0311 226 07
Shoqata "Gruaja e Kuqës në fokusin e zhvillimit".	-	-	-	-	-	-	-	-	Bibliotekë.	0311 225 37

Kisha Katolike, Fondacioni "Shën Asti"	--	--	--	--	--	--	Q e n d ë r për fëmijët me probleme të leme të shëndetit fizik dhe mendor.	Mbështetje për fëmijët me probleme të shëndetit fizik dhe mendor.	03 11 225 91
Drejtoria Juridike dhe e komunikimit me publikun	--	--	--	--	--	--	--	--	0311 233 06
Drejtoria e ndihmës ekonomike	--	--	--	--	--	--	--	Ndihmë ekonomike për familjet.	0311 222 08
Njësia e mbrojtjes së fëmijëve	Këshillim dhe mbështetje për familjet e fëmijët në nevojë.	M e n a x h o n dhe koordinon raste të fëmijëve viktimë të trafikimit dhe të dhunës në familje.	--	--	--	--	--	Mbështetje për fëmijët në nevojë përmes bashkëpunimit me institucione të tjera.	0311 222 08

Qendra e zhvillimit për gratë dhe vajzat	Këshillimi i ofruar përmes linjës telefonike dhe këshillimit ballë për ballë për viktimat e dhunës në familje.	--	--	--	--	--	--	--	--	04 2 233 409 /04 2 233 408	04 2 259 795/ 04 22 41 914 (Tiranë)
Koalicioni i strehëzave antitrafik në Shqipëri	Këshillim psiko-social për viktimat e trafikimit.	Këshillim ligjor; -Avokat për asistencë ligjore; -Asistimi i rasteve për procedura juridike; -Siguri.	Trajnime profesionale për viktimat e trafikimit.	- Mbështetje mjekësore për diagnostikimin dhe trajtimin e problemeve shëndetësore; -Edukim mjekësor.	- Aktivitete sociale; - Aktivitete brenda dhe jashtë shtetit.	Akomodim i sigurt.	- Mbështetje për fëmijët e trafikuar apo në rrezik; - Mbështetje për fëmijët e viktimave të trafikimit.	+355 (0) 33 228 048/ 224 078 (Vlorë) + 355 (0) 545 2919 (Elbasan) + 355 (0) 48 30 2536 (Tiranë) +355 (0) 42 22 1892 (Tiranë) +355 (0) 8426 900 (Gjirokastrë)			
Qendra për nisma ligjore qytetare	--	Asistencë ligjore falas për gratë në nevojë.	--	--	--	--	Mbështetje për regjistrimin e fëmijëve.	04 2 259 795/ 04 22 41 914 (Tiranë)			
CRCA – ALO 116 (Linja Kombëtare për fëmijët në Shqipëri)	-Këshillim për fëmijët; - Referim i rasteve në institucionet qeveritare apo joqeveritare.	--	--	--	--	--	- Këshillim dhe referim në institucione të tjera për adresimin e nevojave të tyre.	116			

Shërbime të rëndësishme për

Emri i Organizatës/ Institucionit	Shërbime psiko- sociale	Asistencë ligjore/ Siguria	Trajnime profesio- nale	Shërbime mjekësore	Aktivitete edukative dhe rikri- juese	Strehim	Nd me
Qendra Kombëtare Pritëse, Tiranë	- Këshillim individual; - Këshillim në grup.	- Këshillim ligjor nga juristja e qendrës; - Ndjekje e procedurave ligjore në raste denoncimesh; - Siguri.	Trajnime profesio- nale kryesisht në qendër dhe jashtë saj.	Asistencë mjekësore.	Aktivitete informuese, krijuese dhe argëtuese.	Akomodim të sigurt dhe të përkohshëm.	Ko fan Vo
Organizata "Të Ndryshëm & Të Barabartë", Tiranë	- Këshillim individual; - Këshillim në grup; - Asistencë psikologjike.	- Kontakte të rregullta në avokat për asistencë dhe këshillim ligjor; - Asistim i rasteve për procedura juridike/ligjore; - Siguri.	- Trajnime të ndryshme profesio- nale; - Kurse të ndryshme për fuqizimin e VoT.	- Asistencë mjekësore për diagnostikimin dhe trajtimin e problemeve shëndetësore; - Analiza të ndryshme mjekësore; - Ndjekje e shtatzanisë; - Shërbime mjekësore për fëmijët e VoT; - Shërbime dentare; - Edukim mjekësor.	- Aktivitete sociale; - Aktivitete argëtuese, krijuese, informuese, okupacionale, dhe bibliotekë; - Aktivitete brenda dhe jashtë shel- terit.	- Strehim të sigurt, shelter; - Asistencë dhe mbështetje për gjetjen e një apartamenti të sigurt; - Mbështetje financiare për apartamente të VoT.	- K inc - K gru - M i ko në tel dh tak dr viz fan - B me gja të të
Qendra "Psiko-Sociale", Vlorë	Këshillim psiko-social.	- Asistencë ligjore; - Këshillim ligjor.	- Trajnime dhe kurse të ndryshme, profesionale.	Asistencë mjekësore, mjekime, injeksione etj.	- Aktivitete sociale, argëtuese dhe edukuese. - Aktivitete të ndryshme jashtë qendrës.	- Akomodim të sigurt të përkohshëm; - Referim në qendra të tjera për asistencë afatgjatë.	- K rre fan - T dh fan

EX II

ër VoT në Shqipëri dhe Greqi

Përmjetësim e familjen	Punësimi	Edukim	Asistencë për fëmijë	Të tjera	Kontakte
Kontakte me miljarët e T.	-	Aktivitete edukative, ndihmë VoT në këndim dhe matematikë.	Aktivitete argëtuese dhe edukative për fëmijët e VoT.	- Referim në qendra riintegruese; - Monitorim në vazhdimësi.	Adresa: Linzë, Tel.: +355 (0) 48302537 Tiranë.
Këshillim individual; Këshillim në grup; Kundësimi Kontakteve e familjen përmjet telefonatave e Kurseve të Kujtpërdrejta, Karta në Këshilljet e VoT; Këshillim dhe Këshillim në Këshilljet e familjen Këshillim në procesit riintegrimit VoT.	- Këshillim individual dhe në grup për çështje të punësimit; - Asistencë dhe mbështetje për gjetjen e një pune të sigurt.	- Regjistrimi dhe ndjekja e rasteve në shkollë; - Aktivitete të ndryshme edukative.	- Mbështetje për fëmijët e trafikuar apo në rrezik; - Mbështetje për fëmijët e viktimave të trafikimit; - Sistemimi i fëmijëve të VoT në çerdhe dhe kopështe; - Aktivitete të ndryshme edukative me fëmijët e VoT.	- Monitorim i vazhdueshëm pas daljes nga shelteri dhe program; - Mbështetje për hapjen e mikrobizneseve të vogla me qëllim fuqizimin e VoT.	Adresa: Rr. Dora D'istria, Pall. Alb Milenium, Shk. 4, Ap. 39 Tiranë Tel.: +355(0) 222 18 92 e-mail: different&equal@icc- al.org
Kontakte të gullta me miljarët e VoT; Këshillim e vizita në milje.	Asistencë për gjetjen e punës.	- Aktivitete të ndryshme edukative; - Asistencë në regjistrimin e VoT në shkollë.	-	Mbështetje për hapjen e mikrobizneseve të vogla.	Adresa: Lagjja: Isa Buletini, rruga, "Sadik Zotaj", Vlorë Tel: 33 22 40 78 Vlorë e-mail: qvatra@alcom. al

MANUAL PËR MIGRANTËT

Shoqata "Tjetër Vision", Elbasan	Këshillim psiko-social	- Këshillim ligjor; - Mbështetje juridike; - Siguri.	Kurse të ndryshme dhe formim profesional.	- Ndihmë mjekësore; - Edukim shëndetësor.	Aktivitete të ndryshme brenda dhe jashtë qendrës.	- Akomodim të sigurt dhe të përkohshëm; - Siguri.	Vizita takimi familje viktimit
Qendra Pritëse, Gjirokatër	Këshillim psiko-social.	- Këshillim ligjor; - Siguri.	—	Ndihmë mjekësore për probleme akute.	Aktivitete sociale në qendër.	Akomodim të sigurt të përkohshëm.	Kontaktim familje nëpërmjet telefonit
SHKBESH(Shoqata Kristiane e të Burgo-surve të Shqipërisë)	Këshillim psiko-social.	—	Kurse profesionale.	—	—	—	
Komisioneri për mbrojtjen nga diskriminimi							

Shërbime për viktime

KLIMAKA	Mbështetje psikologjike.	Këshillim ligjor	- Kurse në gjuhën greke; - Rehabilitim në punë për gratë që i kanë mbijetuar dhunës dhe trafikimit.	- Kujdes mjekësor.	
OJF, Solidariteti	Mbështetje psikologjike, psikiatrike dhe sociale.	Konsulencë ligjore.	—	Kujdes mjekësor.	
Monitorimi i Grupit Grek të Helsinkit "GHM"	--	Shërbime ligjore për viktimit e trafikimit.		--	--

MANUAL PËR MIGRANTËT

dhe e me arët e ave.	- Këshillim për gjetjen dhe mbajtjen e punës; - Mbështetje për gjetjen e punëve për VoT.	- Asistencë për regjistrimin e fëmijëve të VoT në shkollë; - Aktivitete edukative dhe sociale me to.	- Qendër ditore për fëmijët; -Aktivitete sociale, edukative dhe sportive me to.	Monitorim të rasteve dhe referim në qendra të tjera. Mbështetje për hapjen e mikrobizneseve të vogla të VoT.	Adresa: Lagja: Aqif Pasha, rruga, "Ali Arapi", nr. 19 Elbasan Tel.: +355 054 52 919 e-mail: tjetervizion@gmail.org
kte me arët mjet natave.	-	-	Asistencë për fëmijët e VoT.	Referimi i rasteve në qendra të tjera për riintegrim.	Tel.: +355 (0) 84269025 Gjirokastër
-	Mbështetje për gjetjen e një pune.	Mbështetje në regjistrimin e VoT në shkollë.	-	Mbështetje financiare për pagesë qiraje të apartamenteve të VoT.	Adresa: Rr. "Musa Agolli", nr. 35 Tiranë. Cel.: +355 (0) 682019860 (0)69 4090676 e-mail: reception@shkbsh.com
					Adresa: Rr. "Sami Frashëri", nr. 10, Kati II, Tiranë Tel.: +355 4 243 1078 e-mail: info@kmd.al Web: www.kmd.al

t e trafikimit në Greqi

	- Strehim.	-	-	Adresa: 30-32 Evmolpidon st. 118 54 Athens, Greece Tel.: +30 210 3417160-3, fax+30 210 3417164 e-mail: shelter@klimaka.org.gr website: www.klimaka.org.gr
	Strehim për viktimat e trafikimit dhe të shfrytëzimit për punë.	-	-	Adresa: ΑΛΛΗΛΕΓΓΥΗ Μ.Κ.Ο. ΤΗΣ ΕΚΚΛΗΣΙΑΣ ΤΗΣ ΕΛΛΑΔΟΣ 34 Leonidou str. 104 36 Athens Tel.: centre: 0030 210 5203031, Fax: 0030 210 5233624 www.solidarity.gr e-mail: radh@solidarity.gr Tel.: 800 11 37777
	-	-	-	Adresa: P.O. Box 60820, GR-15304 Glyka Nera Telephone: (+30) 210.347.22.59 Fax: (+30) 210.601.87.60 e-mail: office@greekhelsinki.gr website: http://www.greekhelsinki.gr

MANUAL PËR MIGRANTËT

Shoqëria Ndërkombëtare për Mbrojtjen e Familjes "FRONTIDA CARE"	Mbështetje psikologjike	Ndihmë ligjore	Trajnime dhe mundësi rehabilituese	-	
Rrjeti evropian i grave	-	Siguri	Punësim për viktimat e trafikimit.	Kujdes mjekësor.	
Qendra e Mbrojtjes së të Drejtave të Njeriut (KEPAD)	-	Këshillim ligjor për të huajt, për viktimat e trafikimit dhe viktimat e shfrytëzimit në punë.	-	--	

MANUAL PËR MIGRANTËT

-	Strehim për viktimat e trafikimit dhe të dhunës në familje për gra dhe fëmijë.	-	-	Adresa: 3, Messinias Street, Ambelokipi, Athens Tel.: +(30) 210-8103496 Tel. & Fax: +(30) 210-6923136 Cell phone: +(30)-6973 871004 (24h) e-mail: frontis@otenet.gr
--	Strehim për viktimat e trafikimit.	-	-	Zyra Qendrore: Amaliados 15, 11523, Athens, Greece Tel.:- fax : +30 210 6411449, 0030 210 7704574 e-mail: nroubani@gmail.com Degë: Estias 25, 11526, Athens, Greece Tel.: +30 210 7703043, Fax +30 210 7786886 e-mail: enow@otenet.gr Degë: Ilioupoleos 112, 17237, Dafni, Athens, Greece Tel.fax: 210 9700814 e-mail: enowjobs@gmail.com Website: http://www.enow.gr/ Tel.: 8001114400
--	--	-	-	Adresa: 8, Naiadon str. 11634, Athens, tel.: + 30 210-9210977, fax: +30 210-9246056 www.kepad.gr

ANNEX III

Harta e shërbimeve

Emri i Organizatës/ Institucionit	Shërbime psiko- sociale	Asistencë ligjore/ Siguri	Trajnime profesionale/ Punësim	Shërbime mjekësore	Ak edu arg
Ambasada e Greqisë, Tiranë	--	-	--	--	
Konsullatë e Përgjithshme, Gjirokastrë	--	--	--	--	
Konsullata e Përgjithshme, Korçë	--	--	--	--	
Ambasada Shqiptare, Greqi	--	--	--	--	
Konsullata e Përgjithshme Shqiptare në Janinë, Greqi	--	--	--	--	

e në Greqi

aktivitete dukuese dhe përbërëse	Strehim	Asistencë për fëmijët	Informacion i dobishëm	Adresa dhe kontakte
--	--	-	Informacion për dokumentet që nevojiten për marrjen e vizave të ndryshme.	Adresa: Rr. "Frederik Shiroka", nr. 3, Tiranë, Shqipëri Tel: (00355) 42 274 668, 4 274669, 42 274670 Fax: (00355) 42 234290 e-mail: gremb.tir@mfa.gr Website: ttp://www.mfa.gr/Tirana
		-	--	Adresa: Sheshi "Çerçiz Topulli", Gjirokastra, Shqipëri Tel: (00355) 84 263804, 84 263091 Fax: (00355) 84 262011 e-mail: grgencon.arg@mfa.gr
	--	-	Informacion për lloje të ndryshme vizash, viza studimi, bashkim familjar etj.	Adresa: Rr. "Pavlo Kastro", nr. 4, Korçë, Shqipëri Tel.: (00355) 82 252888 / 82 252889 / 82 245734 Fax: (00355) 82 2450 52 E-mail: grgencon.kor@mfa.gr
	--	-	Informacion rreth nevojave të emigranteve gjatë qëndrimit jashtë vendit.	Adresa: 7, Vekiareli GR., 15237 Filothei, Athens, Greece Tel: (+30) 210 6876200 - Fax: (+30) 210 6876223 E-mail: embassy.athens@mfa.gov.al; albem@ath.forthnet.gr
--	--		Informacion mbi dokumentet e nevojshme për marrjen e lejes së qëndrimit.	Konsullata e Përgjithshme Shqiptare në Janinë Str. Foti Tzavella 2 Ioannina, Greece Tel.: +30 26510 21330 Fax: +30 26510 37768

MANUAL PËR MIGRANTËT

Konsullata e Përgjithshme Shqiptare në Selanik	--	--	--	--
Organizata Ndërkombëtare për Migracion, (IOM)	-	--	--	--
Instituti i Sigurimeve Shoqërore, (IKA)	-	-	-	-
Drejtoria e punësimit, (OAED)	--	-	Punësim kryesisht në bujqësi.	-
Qendra për dhunën ndaj grave	- Shërbime psiko-sociale; - Këshillim.	--	--	--
Shoqata për të drejtat e grave	- Shërbime psiko-sociale; - Informacion rreth të drejtave të grave.	-	-	-
Sindikatat në Greqi, Konfederata e Përgjithshme e Punëtorëve Grekë (GSEE)	-	-	-	-

MANUAL PËR MIGRANTËT

--	--	Regjistrim për fëmijët	Mbështetje për marrjen e pasaportave biometrike.	Konsullata e Përgjithshme Shqiptare në Selanik, Greqi. 6, Odysseos Str. 546 27 Thesaloniki Greece Tel.: +3031 547435, 3031 5474494 Fax: +3031 546656
--	--	--	Informacion për migracionin në përgjithësi.	Adresa: , P.O. Box 430, GR-174 02 Alimos Greece Tel.: 0030 2 10/99.19.040 Fax: 0030 2 10/99.10.914
--	--	--	Informacion rreth sigurimeve shoqërore për të punësuarit.	Adresa: Agiou Konstantinou 8, Athens 10241 Tel.: + 30 210 5224861 Fax: + 30 210 5229180 Website: http://www.ika.gr
--	--	--	-	Adresa: Ethnikis Antistasis 8 str. GR-17456 Alimos, GREECE Tel: +30 21 - 09989000 FAX number (Governor): +30 21 - 09989500 Postal Box: 77117 / 17510 P. Faliro, GREECE e-mail: a5@oaed.gr Web: www.oaed.gr
--	--	--	--	Adresa: Tel.: 210-3317305-6(Athens) and 210-4112091 (Pireaus)
--	--	--	--	Adresa: Tel: 210- 3626460 / 3616236 Bashkia, Athine, Equality Bureau, Tel.: 210- 5244657
--	--	--	Informacion rreth të drejtave të emigrantëve.	+30 210 8834611-15 +30 210 8202186, 210 8202187 info@gsee. gr www.gsee.gr